




Me ngjyrë kandidatët/ët me prejardhje/shtetësi nga Kosova

**TË VOTOSH DOMETHËNË TË BASHKËVENDOSËSH!** Më 20 tetor ne do të rizgjedhim anëtarët e Parlamentit dhe Senatit. Shumëçka do të varet nga këto zgjedhje: premi më të ulëta të sigurimeve shëndetësore, punë dhe arsimi për të gjithë, barazi gjinore konsekuente dhe mbrojtje të klimës. Ne angazhohemi për një Zvicër të hapur, sociale dhe ekologjike për të gjithë. Sepse Zvicra do të jetë e fortë vetëm atëherë kur ndihen mirë të gjithë e jo vetëm një pakicë e vogël.

**SP MigrantInnen PS Migrant-e-s PS Migranti/e**

# SHANSE TË NJËJTA, TË DREJTA TË NJËJTA: NJË ZVICËR EINE PËR TË GJITHË

### NJË E DREJTË PËR PUNË PËR TË GJITHË

Të gjithë pa diskriminim duhet të kenë qasje për arsimim dhe punë: Falë nxitjes dhe njohjes së diplomave dhe kualifikimeve tjera profesionale nga vendi amë.

### PËR NATYRALIZIM DHE PJESËMARRJE POLITIKE

Një çerek i popullatës nuk ka të drejtë zgjedhjeje dhe vote. Ky deficit i madh demokratik është i papranueshëm. Natyralizimi duhet të lehtësohet dhe të garantohet e drejta për pjesëmarrje politike për të gjithë.

### RESPEKT DHE SHANSE TË NJËJTA PËR MIGRANTET

Migrantet shpesh diskriminohen dyfish. Qasja e tyre në punë, arsimim dhe politikë duhet të përmirësohet dukshëm. Vetëm kështu mund të vijë në shprehje potenciali i këtyre grave.

### TË PRANOHEN DIVERSITETI DHE DINJITETIT NJERËZOR

Popullata në Zvicër është jashtëzakonisht e shumëllojshme. Politika duhet të pranojë realitetin e ri shoqëror dhe të kujdeset për barazi faktike dhe për një shoqëri inklusive (gjithëpërfshirëse).

# UDHËZIMI PËR VOTIM

Procedura e saktë ndryshon nga kantoni në kanton. Në parim, votimi korrekt bëhet si në vijim:



Hapeni zarfin zyrtar të votimit




Shkëputni listën e PS-së për parlamentarë nacional (Nationalrat). E rëndësishme: Duhet të përdoret vetëm një listë e vetme!




Shkëputni fletëvotimin e PS-së për senat (Ständerat) ose shkruani emrat e kandidatëve të PS-së në fletën e votimit bosh



Vendose fletëvotimin për senat (Ständerat) dhe listën e deputetëve nacional (Nationalrat) të PS-së në zarfin anonim të votimit




Nënshkruaje kartën e votimit



Vendose zarfin e votimit dhe kartën e votimit në zarfën zyrtare. Adresa e kthimit duhet të jetë e dukshme në dritaren e zarfit zyrtar.



Zarfi i votimit përmes postës duhet deri më 15 tetor ti kthehet prapa komunës, ose deri më 19 tetor të hedhet në kutin e postës së administratës komunale.

**www.spmigrantinnen.ch/alb www.psmigrants.ch/alb**